



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Ky përditësim mbulon zhvillimet që nga përditësimi i fundit përpara fillimit të pushimit veror të gjykatës. Gjatë kësaj periudhe nuk pati seanca, as përditësime për shtyp, por aktivitetet e tjera të gjykatës vazhduan pa ndërprerje.

Në çështjen e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 28 korrik dhe 10 gusht, Trupi Gjykses, në dy vendime, urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Rexhep Selimit dhe Hashim Thaçit, duke konstatuar për të dy të akuzuarit se vazhdon të ekzistojë rreziku që ata mund të pengojnë ecurinë e procesit dhe të kryejnë vepra penale të tjera. Trupi Gjykses gjykoi se duket se z. Selimi ka nxjerrë informacion të privilegjuar për palë të treta të paautorizuara dhe se duket se z. Thaçi u dha vizitorëve jo të privilegjuar informacion të marrë gjatë dhënies së dëshmime prej dëshmitarëve të mbrojtur dhe diskutoi udhëzime që duhej t'u kaloheshin dëshmitarëve në lidhje me formën dhe përmbajtjen e dëshmime të tyre.

Në vendimet e veta, Trupi Gjykses rikujtoi gjithashtu se emrat dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve tejet të cënueshëm janë nxjerrë për të akuzuarit, çka rrit rrezikun që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun. Gjykatësit kujtuan atmosferën e vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë dhe konstatuan se këto rreziqe mund të ulen mjaftueshëm vetëm nëpërmjet kornizës për monitorimin e komunikimit që zbatohet në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 29 korrik, Trupi Gjykses miratoi një kërkesë të Mbrojtjes së Viktimave për të lejuar një të afërm të ngushtë të një viktime që ka ndërruar jetë të vazhdojë pjesëmarrjen në proces. Në këtë çështje gjyqësore marrin pjesë gjithsej 156 viktima.

Kujtojmë se Trupi Gjykses do të shqiptojë Aktgjykimin në këtë çështje gjyqësore më 16 shtator 2026, duke filluar në orën 10:00 me orën e Evropës Qendrore.

Janë duke u shqyrtuar të gjitha kërkesat për përcjelljen e seancës së 16 shtatorit në gjykatë, të dërguara para afatit. Për shkak të numrit të kufizuar të ulëseve në galerinë për publikun dhe numrit të madh të kërkesave për pjesëmarrje në këtë seancë, procesi i shqyrtimit merr kohë. Sikurse u tha në njoftimin e parë, konfirmimi me postë elektronike do të dërgohet brenda dy javësh përpara seancës.

Shqiptimi i Aktgjykimit do të transmetohet edhe në internet nëpërmjet faqes së DHSK-së për transmetim në shqipe, anglishte dhe serbishte. Sikurse me të gjitha seancat publike të tjera, nuk nevojitet regjistrimi për të përcjellur shqiptimin e Aktgjykimit në internet.





Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit lidhur me pretendimin për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, Gjykatësi i Vetëm i Ngarkuar me Gjykimin e Çështjes mbylli procedurën e paraqitjes së provave, dhe caktoi datat për paraqitjen e deklaratave përmbyllëse më 10, 11 dhe 14 shtator 2026, ku seancat do të fillojnë në orën 9:30 me orën e Evropës Qendrore, në të tri ditët. Në të njëjtin urdhër, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi që çdo kërkesë nga të akuzuarit për të marrë pjesë në deklaratat përmbyllëse nëpërmjet videokonferencës duhet të dorëzohet deri më 14 gusht. Bazuar në parashtrimet publike, z. Smakaj, z. Kilaj, z. Fazliu dhe z. Kuçi kanë dorëzuar kërkesa për të marrë pjesë në seancë nga distanca.

Seancat më 10, 11 dhe 14 shtator do të jenë publike dhe mund të përcillen në shqipe, anglishte dhe serbishte nëpërmjet faqes së DHSK-së për transmetim, ose nga galeria për publikun në gjykatë. Konfirmimi me postë elektronike për ata të cilët janë regjistruar paraprakisht për të ndjekur këto seanca do të dërgohet dy javë përpara deklaratave përmbyllëse.

Po në këtë çështje gjyqësore, më 24 korrik, Gjykatësi i Vetëm i Ngarkuar me Gjykimin e Çështjes hodhi poshtë një kërkesë të Mbrojtjes së Smakajt për apelim të vendimit të Gjykatësit me të cilin deklarata e dëshmitarit 8 u pranua si provë, pas vendimit të Dhomës së Apelit mbi këtë aspekt. Ndër të tjera, Gjykatësi i Vetëm i Ngarkuar me Gjykimin e Çështjes konstatoi se Mbrojtja e Smakajt nuk tregoi se ky aspekt do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e shpejtë dhe të drejtë të procesit.

Po atë ditë, Gjykatësi i Vetëm i Ngarkuar me Gjykimin e Çështjes miratoi një kërkesë të Mbrojtjes së Thaçit për të pranuar si prova tri parashtrime publike nga procese gjyqësore në gjykata të tjera, vetëm për të treguar kuadrin e ngushtë të detyrimeve të konfidencialitetit në lidhje me ekspertiza të mikropikave. Kjo ka të bëjë me dëshmitarin, 8, një dëshmitar ekspert i thirrur nga Prokuroria në këtë gjykim i cili nuk pranoi të jepte informacion të caktuar gjatë dëshmisë së tij, për arsye të konfidencialitetit.

Më 31 korrik, Gjykatësi i Vetëm i Ngarkuar me Gjykimin e Çështjes urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit, me konstatimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi mund të pengojë ecurinë e procesit dhe të kryejë vepra penale të tjera.

Më 29 korrik, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, Ekaterina Trendafilova hodhi poshtë kërkesën e mëparshme të Haxhi Shalës për t'iu lejuar udhëtim për pushime në Shqipëri. Kryetarja modifikoi dënimin e z. Shala në shkurt të këtij viti pasi kishte kryer 2/3 e dënimin, dhe u lirua me disa kushte në Kosovë, përfshirë kufizime për udhëtim jashtë Kosovës gjatë pjesës së mbetur të dënimin.

Në vendimin e parë mbi këtë kërkesë, Kryetarja konstatoi se udhëtimi për të shkuar për pushime është tërësisht në kundërshtim me dënimin që iu dha z. Shala. Në vendimin e saj të 29 korrikut, ajo përsëriti se pushimi nuk përbën arsye mjaftueshëm bindëse për të udhëtuar jashtë Kosovës dhe i rikujtoi se ai duhet të respektojë të gjitha kushtet e lirit. Ajo rikujtoi gjithashtu z. Shala pranoi fajësinë për vepra penale të rënda





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**
Nr. 29/2026
Hagë, 20/08/2026

dhe se kushtet e vendosura për lirimin e tij do të shfuqizohen pas pak muajve, më 11 dhjetor 2026, kur ai të ketë kryer dënimin.

